

V E N D I M
Nr.62, datë 5.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.76 Akti që i përket:

KËRKUES: THOMA MIÇO

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

4. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
5. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.98, në mungesë.
6. THEODHORI BEJ, përfaqësuar nga avokat Ardian Nuni.
7. LEONARD DEMI, përfaqësuar nga avokat Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.971, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kryetarin Fehmi Abdiu, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.971, datë 29.6.2001 ka vendosur: “Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.98, duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet. Zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.98, më 8.7.2001, midis kandidatit për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotit Theodhori Bej dhe kandidatit të pavarur, zotit Leonard Demi”.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi Thoma Miço, i cili ka kërkuar deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të rezultatit të votimeve në zonën zgjedhore nr.98 Delvinë, duke parashtruar se një vëzhgues, përfaqësues i PBDNJ-së, është lejuar të marrë pjesë në procesin e votimit; është bërë manipulimi i procesit të votimit, kanë votuar shtetas që banojnë jashtë shtetit; se dokumentet e Komisionit të Qendrave të Votimit janë plotësuar në Komisionin Zonal Zgjedhor e se nuk janë vlerësuar drejt fletët e pavlefshme të votimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua se kërkesa e kërkuesit është e pabazuar. Ai ka paraqitur para Gjykatës deklarata personale të personave të veçantë për të provuar pretendimet e tij, ndërkohë që përfaqësuesit e tij pranë KQV-ve nuk kanë parashtruar rezerva në përfundim të procesit zgjedhor e as në momentin e nënshkrimit të procesverbalit. Po kështu, nuk kanë paraqitur pretendime për parregullsi në procesin zgjedhor as përfaqësues të veçantë të KZZ-së.

Veç këtyre, ai nuk ka paraqitur ankim as në organet gjyqësore e as në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto rrethana, kërkesa e tij konform nenit 113 të Kodit Zgjedhor, duhet rrëzuar si e

pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.